

KAPITULLI NENTE

AMBJENTI

9.1 HYRJE

Qellimi i ketij kapitulli është identifikimi i çështjeve të mjedisit të një tipi strategjik, dhe skicimi i projekteve dhe programeve që synojnë përbalimin e tyre.

Ky diskutim është i bazuar deridiku në punën e vazhdueshme të 'Projektit të planifikimit dhe Legjislacionit të Ambjentit' (ELPA) që është financuar nga KE nën kontrollin e Ministrisë së Mjedisit. Ky projekt nuk do të perfundohet deri në vitin tjetër. Është e keshillueshme që të rishikohet Plani Rajonal kur të perfundojë ELPA, sa për t'u siguruar që të dy strategjitë janë krejt të përputhshme.

Shumë çështje të mjedisit të mbuluara nga ELPA diskutohen në tituj të tjerë të Planit Rajonal. Për shembull, në kapitullin mbi 'Zhvillimin Ekonomik' diskutohet mbi turizmin dhe agrikulturën; në 'Infrastrukturën Strategjike' diskutohet mbi drenimin dhe çështje të lidhura me të; dhe në kapitullin 'Rritja Urbane' diskutohet mbi planifikimin lokal dhe kontrollin e zhvillimit plus ujesjellesit dhe kanalizimet tresetore.

Kur projektet e veçanta të jenë duke u përpunuar në detaje me të medha është e pelqyeshme të përgatitet një 'vlerësim strategjik të mjedisit'. Kur të jenë të skicuara në thellësi, duhet të përgatitet një 'deklarate ndikimi mbi mjedisin'. Kjo duhet të raportohet het në Ministrinë e Mjedisit, aprovimi i së cilës duhet të merret. Do të ishte me efektive nëse ministria ka qenë e përfshirë në secilin projekt që ditet e para. Projekti i ELPA do të paraqesë detajet e përjasjes, dhe sfondin në legjislacionin Evropian mbi mjedisin, me të cilin Shqipëria duhet të familjarizohet gjithnjë e më tepër.

9.2 DISKUTIM I TEMAVE KYÇE

9.2.1 Menaxhimi i Sistemit të Lumenjve

Sistemi i lumenjve në fushën bregdetare ka ndryshuar si rezultat i ngjarjeve historike afatgjata. Lumenjtë Buna, Drin dhe Kir bashkohen në dalje të Shkodrës, në jug. Ketu lumenjtë arrijnë një nivel të lartë të ujërave në periudhën e dimrit dhe pengojnë rrjedhjen nga Liqeni i Shkodrës. Kjo sjell përmbajtje, por edhe bllokim të rrjedhjes nga kanalet e ujërave të zeza dhe drenimeve nga zona urbane. Kjo është keqesuar nga transportimi i materialeve të geryera, gjë që ka reduktuar kapacitetin rrjedhës të lumenjve.

Në fillim, Akademia e Shkencave propozoi një kanal nga Drini (fill në jug të Vau i Dejes) deri përtej Bushatit, duke u bashkuar me Bunën në njëfarë distance në veri të detit. Kanali do të ngrihej në disa vende me gjashtë metra mbi nivelin ekzistues të tokës, dhe kostoja do të ishte mjaft e lartë (€ 100 milion) në krahasim me përfitimet e mundshme. Nderkohe që ky koncept duhet të studjohet me thellë, duket që është me e arsyeshme të adoptohet një zgjidhje me modeste.

Një koncept alternativ do të ishte reduktimi i rrjedhjes së derdhur në Bunë

- (a) duke rihapur lumin Gjader, duke e lejuar atë të rrjedhë për nga jugu i detit; dhe
- (b) duke ribashkuar Drinin kryesor me Drinin e Poshtëm, (duke e përdorur atë për devijimin e një pjese të rrjedhës së Drinit kryesor).

Projekti fillestar i kanalit të Bushatit do të mbështetej nga një skemë perkatëse energjie hidrike (150 GWh në vit). Por një kanal me i shkurtër nga Vau i Dejes, që bashkohet me Drinin kryesor rreth pesë kilometra më në perëndim, do të ishte një fraksion i kostonë dhe më pak i pakëndshëm për syrin, nderkohe që gjeneron 50 GWh në vit.

Koncepti i sapo përmendur do të kërkonte gjithashtu heqjen e depozitimeve përmes thellimit të shtratit të lumenjve duke synuar kështu rritjen e kapacitetit rrjedhës të të tre lumenjve.

Propozimet e tjera kanë qenë

- (a) të ndërtohet një pendë përmes Bunës, në jug të Shkodrës, në mënyrë që të lejohet mbajtja konstante e nivelit të liqenit dhe
- (b) të ndërtohen pendë përgjate Bunës për kontrollimin e përmbajtjeve.

Keto ide mund të rishikohen.

Argumentohet se nuk është nevoja të mbahet liqeni në nivelin e tanishëm. A do të kishte disavantazhe nëse do të binte me dy ose tre metra, në pozicionin e tij historik? Dhenia fund e përmbajtjeve të tokës në perëndim të Shkodrës dhe përgjate Korridorit Shkoder-Koplik do të asistonte projektet e ardhshme të zhvillimit të paraqitura në Kapitullin 6. Gjithashtu, do të asistonte edhe rrjedhjen e zhblokuar të ujërave të zeza dhe atyre të sipërfaqes nga infrastruktura e zonës urbane.

Ndërtimi i pendëve të medha për kontrollin e përmbajtjeve është shpesh një ndërmarrje mjaft e dyshimte. Mund të mendohet si më e mençur dhe me kosto-efektive lejimi i përmbajtjeve me të rralla në zonat e pazhvilluara në lindje të Bunës, por gjithmone

nese fusha e permybtjes se emergjences nuk ka banesa. Prandaj, do te kishim tendencen te vinim ne pikepyetje nevojën per pende te reja pergjate Bunes. Nga ana tjeter, ka vende te tjera ku pendet ekzistuese ndalin permybtjen e zonave urbane ekzistuese dhe keto pende duhet te mirembahen tamam.

Ketu koncepti bazohet ne filozofine e te shkuarit 'me' natyren me teper sesa te projektohet 'rezistence' ndaj saj. Eshte e qarte qe nevojitet me teper studim. Per sa i perket gjenerimit te energjise, kjo duhet te shihet ne kontekstin e politikave kombetare per energjine. Projekte te tjera per energjine termike po debatohen ne Vlore. Projektet e energjise hidrike ne Shqiperine e Veriut duhet te shfaqin nje performance ekonomike te pershtashme ne strukturen e politikave kombetare per energjine. Ne vecanti, keto projekte te energjise nuk adresojne gjithmone kerkesa te ngarkesave elektrike kulmore.

9.2.2 Mbeturinat e Ngurta

Ne kete krahine (ashtu si kudo tjeter ne Shqiperi), deshtimi ambjental me i dukshem eshte hedhja kudo e mbeturinave. Kur keto mblidhen, normalisht hidhen ne skajin e qyteteve dhe digjen. Ne disa raste, tymi perhapet ne fshatrat e afert. Mbeturinat mjekesore dhe hedhja e tyre ne kanalet ujites paraqesin rrezique te vecanta shendetesore.

Nevojitet nje vend higjienik i mbushjes se tokes. Qytetet dhe fshatrat e ndryshme ne nje zone urbane duhet te kene nje vend te njejte. Nje vend i tille eshte propozuar ne Plezhe, afer Bushatit, qe arrihet nga autostrada Shkoder-Lezhe, sic e tregon harta e Planit Rajonal (Figura X).

Sistemi per mbeturinat e ngurta do te kerkoje gjithashtu kazane dhe automjete mblidhese te reja, te cilat do te kene nevojë per garazhe dhe pika mirembajtjeje/karburanti. Per me teper, do te nevojitet nje makine blujtese dhe shtypese per te ricikluar mbeturinat qe shtohen, si dhe parashikohet nje hapësire per thyerjen e makinave. Deshirohen edhe vende per perzgjedhjen dhe ndarjen e kategorive te ndryshme te mbeturinave ne disa konteniere.

Kostoja e buxhetit mendohet te perfshije shtesen e artikujve kryesore te tille. Gjithsesi kostoja operative, qe perfshin karburantin, mirembajtjen dhe rrogat, duhet te nixirret nga pagesat e te interesuarve.

9.2.3 Agrikultura

Ndoshta nuk eshte aspak egzagjerim te thuhet se ne kete rajon agrikultura eshte ne renie serioze, paçka se

ne me te shumten e vendeve te Evropes Perendimore komuniteti i fermerëve zakonisht shihet si rojtari kyç i cilesise se ambjentit rural. Ndoshta perfitimi ambjental me i madh do te rrjedhe nga nje sektor agrikulturor ekonomikisht i aresyeshem, nese eshte i mireorganizuar ne menyre te mjaftueshme per te dhene 'mbrojtje ambjentale'.

Ne kontekstin e tanishem ka dy çështje. Shqetesimi i pare ka te beje me pronesine e tokes apo kontrollin. Pronat e tokes jane shume te vogla dhe te shperndara. Nje ferme duhet te jete mes 10 dhe 50 hektarësh (brenda nje kufiri te vetem) qe te funksionojë ekonomikisht. Qellimi i kesaj strategjie eshte rigrupimi i pronave te tokes ne kete menyre, dhe çështja shqyrtohet ne kapitullin mbi Zhvillimin Ekonomik.

Tema e dyte ka te beje me drenimin dhe ujitjen e tokes. Zona ka rrjete te zgjeruara kanalesh te cilat nuk mirembahen dhe nuk shfrytezohen. Nje agjensi me fonde duhet te jete e pergjegjshme per elementet paresore dhe dytesore te sistemit, dhe feramat individuale duhet te (a) mirembajne kanalet tretesore dhe (b) te paguajne per perfitimet nga kanalet paresore dhe dytesore. Kjo nuk do te jete e mundur ne fillim sepse industria agrikulturore se pari duhet te mberrije nje gjendje te qendrueshme ekonomike. Edhe kjo çështje diskutohet ne kapitullin e Zhvillimit Ekonomik.

9.2.4 Mbrojtja Ekologjike dhe Zhvillimi i Turizmit

Disa zona ekzistuese gezojne nivele te ndryshme mbrojtjeje nen Ligjin 8906 te vitit 2002, dhe propozime te tjera do te dalin nga projekti ELPA. Keto perfshijne (a) zona rreptesisht te kontrolluara (rezervate shkencore dhe natyrale); (b) Parqe Kombetare; (c) pejsazhe te mbrojtura dhe (d) zona habitatesh te menaxhuara. Secila ka nje nivel te ndryshem mbrojtjeje, dhe zona ne fjale perfshin vijen bregdetare, zonen mes qytetit te Shkodres dhe Velipojes, dhe token mes liqenit e maleve: Shih Figuren 9.1.

Keto zona shihen si ambjentalisht te ndjeshme, vecanerisht lagunat pergjate bregdetit dhe zonat ne lidhje me to. Ato perceptohen si te qena ne rrezik prej urbanizimit te paplanifikuar dhe te pakontrolluar, ndotjes qe shkakton dhe hyrjes ne to te banoreve dhe vizitoreve.

Thuhet qe kjo ka si shtyese presionin nga zhvillimi ekonomik. Por pasojat tashme po e bejne zonen me pak terheqese per turistet, dhe deshtimi ne mbrojtjen e asetëve ambjentale do te shkaktojë debimin e turistëve nga zona. (Tashme udherrefyesi kryesor ne gjuhen angleze u tregon vizitoreve sesa joterheqese

eshte zona dhe i paralajmeron ato "Rrini larg!"). Rreziku eshte qe kjo do te "vrasesh paten qe ben vezen e arte".

Konkluzioni i programit eshte qe te nderprihet gjithë zhvillimi ne nje "Zone Konservimi", e cila perfshin dhe rrethon lagunat bregdetare ne jug te Lezhes si dhe malet ne veri te Shengjinit. Ky "Park Natyror", duhet te jete nen nje rregjim mbrojtjeje dhe menaxhimi te mireorganizuar.

Ne jug te Lezhes dhe ne lindje te kesaj zone duhet te jete nje 'Zone Amortizatore'. Kjo do te perfshinte kater pika nje te cilat do te sigurojne zhvillimin nen nje kontroll te rrepte. Lokalitetet do te ishin Ishull Lezhe, Tale, Fushe Kuqe dhe Shllinza. Ato cka mund te perdoren jane (a) nje hotel i vogel (me pak se 50 shtreter) per çdo nje; (b) deri ne 5 'Shtepi Miqsh' per çdo nje. Shtepite ekzistuese duhet te jene ne gjendje t'u japin dhoma vizitoreve. Do te kishte nje vend parkimi per vizitorët dhe nje 'Qender Shpjeguese'. Duhet te jene te siguruara projekte te infrastruktures per ujin dhe kanalizimin e ujerave te zeza.

Pjesa qe mbetet nga rripi bregdetar duhet te mbrohet si toke per agrikulture. Ne pergjithesi, urbanizimi nuk propozohet fare dhe me te vertete qe duhet te parandalohet. Zhvillimi pergjate rruges se re nga Lezha ne Tirane duhet te vihet nen kontroll, (siç eshte argumentuar ne nje kapitull tjetër). Kjo ka krijuar imazhin me te neveritshem per te gjithë nenrajonin dhe nuk ka prodhuar ndonje perfitim te vertete ekonomik. Sa te jete e mundur ligjerisht, zhvillimi direkt pergjate rruges duhet te priset dhe te zevendesohet me nje rrip pyjor. Rruget per ne Laç dhe Milot (qe te dergojne ne Rubik, Rreshen, Qafe Mali etj) duhet te kryqezojne rrugen bregdetare. Ketu mund te krijohen nje te vogla te mireplanifikuara ekonomikisht (siç u pershkruan ne nje kapitull tjetër).

Strategjia Rajonale paraqet plane lokale per Shengjinit dhe Velipojen, (Shih Kapitullin 6) qe perfshin sigurimin e hoteleve dhe qendrave te sherbimeve ndaj turizmit. Propozimi i rendesishem, nga kendveshtrimi i turizmit, eshte qe asnje rruge apo ndertim nuk duhet te behet midis ketyre qendrave. Plani perfytyron vetem nje shteg pergjate bregdetit dhe nje rrugkalim ciklistik. Vlera e kesaj zone si aset turistik do te çohet dem nese lejohet qe zhvillimi te ndodhe.

Ne kete kapitull mbi 'Zhvillimin Ekonomik', ne propozojme edhe nje shteg panoramik dhe nje rruge ciklistike te gjate perreth Liqenit te Shkodres, me nje ne Shiroke dhe Zogaj te tipit qe pershkruam me sipër.

9.2.5 Pylltaria Ambientaliste

Nevojitet nje pergatitje me e detajuar projekti per te identifikuar projektet e pyllzimit (a) per te stabilizuar token qe po kalon (apo qe po rrezikohet nga) geryerje; (b) per te mbeshtetur rivendosjen e pendave te lumenjve; (c) per te permiresuar ambientet urbane dhe rurale keshtu qe te ndihmohet turizmi dhe aktivitetet e tjera qe gjenerojne investime; dhe (d) per te mbeshtetur konservimin e habitateve te rrezikuara.

Plani perfytyron qe kostoja e te tilla programeve te financohet nga gjenerimi i te ardhurave prej pylltarise komerciale, gje qe diskutohet ne kapitullin mbi Zhvillimin Ekonomik. Kjo perfshin referencen nga 'Pylltaria e Komunitetit'.

9.2.6 Reklamimi i Tokave te Demshme/Ndotura (te braktisura)

Ka nje numer te konsiderueshem zonash me toke te demshme/ndotur apo 'zone kafe' qe permbajne disa kercentime ambientale. Sidoqofte, synimi eshte kthimi i tyre ne kushte ambientaliste te shendetshme dhe t'i zhvillojme ato nese eshte e mundur ne menyrat e pershtashme (perpara se te zhvillohen 'zonat e gjelbra').

Ky plan propozon pese projekte te tille, siç vijon.

- *Zona Industriale e Vjeter ne Veri-Lindje te Qytetit te Shkodres.* Kjo eshte nje zone e gjere me premisa industriale por tani zone mjaft e demshme/ndotur. Ne Kapitullin 8 u identifikua si zone e ardhshme toke biznesi: shih Tabelen 8.2. Nje buxhet u dha per pergatitje dhe infrastrukture.
- *Fabrika e Vjeter e Letres ne Jug te Qendres se Lezhes.* Ky eshte nje vend i demshem/ndotur mjaft dukshem, i cili duhet te pastrohët dhe te kthehet ne perdorim si pjese e zones se biznesit ne qendren e Lezhes: (Tabela 8.2)
- *Superfosfati i Vjeter i Laçit.* Ky eshte vendi i ndotur me rende. Ndertesat duhen rrezuar dhe toka te hiqet tutje apo te mbulohet. Mund te jete shume e veshtire kthimi i asaj toke ne perdorim.
- *Rafineria ne lindje te Vaut te Dejes.* Kjo eshte toke relativisht e ndotur qe kerkon shkaterrim dhe heqje apo mbulim te dheut. Kjo zone nuk do te jete e mundur te perdoret komercionalisht.
- *Miniera e Bakrit ne Rubik.* Kjo nuk eshte ne funksionim, dhe toka eshte shume e ndotur.

Dy vendet e para ne Shkoder dhe Lezhe mund te riperdoren, dhe nje projekt i afte zhvillimi do te mund te gjeneronte nje sasi domethenese te ardhurash per te mbuluar koston e reklamimit dhe infrastruktur es. Ne tre rastet e fundit, gjithsesi, nuk ka te ngjare, dhe ky buxhet i programit te reklamimit nuk do te jete i vetefinancuar.

Nje ceshtje e lidhur me te paren ka te beje me gerryerjen e kodrave nga guroret (a) afer Gjadrit; (b) ne anen lindore te Bunes afer Shkodres dhe (c) ne rrugen Lezhe-Shengjin. Ka gjithashtu dhe shume vende ku agregatet nxirren nga (per shembull) Lumi Mat dhe Buna ne jug te Shkodres.

Guroret jane mjaft te ekspozuara vizualisht dhe te shemtuara. Aktiviteti mund te nxise erozionin. Sido qe te jete, pasi te mbaroje aktiviteti i gurores mund te mos kete restaurim dhe pastrim. Ceshtja e guroveve ka nevoje per konsiderata te metejshme.

Per sa u perket aggregateve qe fitohen nga lumenjte, kjo duhet te integrohet ne projektin thellimit te shtratit te lumenjve qe eshte skicuar me siper: (Projekti E-2). Projekti i mbeturinave te ngurta (E-3) parashikon nje makineri shtypese per te ricikluar mbeturinat e ndertimit, dhe kjo gjithashtu duhet te integrohet me bizneset e aggregateve per sa i perket planifikimit.

9.2.7 Kontrolli i Zhvillimit Urban dhe Evitimi i Shperdorimit te Tokes

Kjo diskutohet ne kapitullin 6 mbi rritjen urbane dhe ne kapitullin 11 mbi Implementimin, veçan erisht per sa u takon planifikimit lokal, densitetit, perforcimit dhe furnizimit tretesor me uje dhe higjienes.

Edhe pse e kemi shqyrtuar kete ceshtje ne vende te tjera, ky mund te jete rreziku i vetem me i madh i ambientit. Toka qe nevojitet si rezervat ambjental apo ekologjik shpesh pushtohet nga ndertesat, dhe toka shperdorohet nga zhvillimi me densitet skajshmerisht te vogel. Infrastruktura nuk sigurohet (sepse densitetet e bejne ekonomiksht te pamundshme) dhe si rrjedhim kalimet e ujit dhe shtresat shkembore me uje jane ndotur ose do te ndoten.

Ne rruget kryesore, vendet ballore shpesh zhvillohen per biznese ekonomiksht anesore, si sheshet e thyerjes se automjeteve (ose sheshe materialesh ndertimi), ose lihen si ndertesat te braktisura e te paperfunduara. Ne shume raste, toka mbushet me aggregate per te sjelle toke agrikulturore prodhimtare ne nivelin e rruges, e me pas braktiset.

9.3 IDENTIFIKIMI I PROJEKTT

9.3.1 Projekti E-1 Ridrejtimi i Lumenjve te Drinit Lezhe dhe Gjader

Ky eshte subjekti i nje studimi me te detajuar, por pjeset e ndara te Gjadrit do te ribashkohen dhe rrjedha e Drinit Kryesor do te drejtohet pjeserisht poshte ne Drinin Lezhe. Do te kete punime shtese per rehabilitimin e te dy lumenjve, si riparimi i pendeve. Kanali (i permendur me siper) mbi Drinin Kryesor mund te justifikohet nepermjet nje projekti te ri hidroenergjetik. Ky shikohet si nje teme vecmas dhe eshte identifikuar ne Kapitullin 7, 'Infrastruktura Strategjike'.

9.3.2 Projekti E-2 Thellimi i Shtratit te Lumit, Restaurimi i Pendeve dhe Pengimi i Materialit te Geryer

Shtreterit e te gjitha lumenjve kryesore do te thelloheshin qe te rritej mjaftueshem kapaciteti i tyre rrjedhes, pendet do te riparoheshin dhe barrierat penguese te sedimenteve do te rehabilitoheshin ose te ndertoheshin te reja, (ç'te jete e pershtatshme).

9.3.3 Projekti E-3 Vend Higjienik per Mbushjen e Tokes afer Plezhes (Bushat)

Ky vend do te projektohej per te permbushur kerkesat e rajoneve te Shkodres dhe Lezhes. Vendet ekzistuese te hedhjes se mbeturinave do te mbylleshin dhe do te rehabilitoheshin. Kostoja perfundimtare e kazaneve dhe automjeteve mbledhese te mbeturinave, ashtu si dhe vendet dhe mjetet per perzgjedhjen, shtypjen dhe riciklimin, jane te perfshira ne koston e projektit. Ne gjithashtu perfytyrojme qe koston e operatorit do te nxirren nga autoritetet rajonale ne baze te pagesave te te interesuarve.

Projekti perfundimtar duhet te planifikohet tani qe te plotesoje kerkesat per mjaft dekada, por vleresimi ketu ka per qellim te mbuloje vetem fazen e pare prej dhjete vitesh.

9.3.4 Projekti E-4 Rehabilitimi i Kanaleve dhe Hidrovoreve

Sistemi paresor dhe dytesor i kanaleve per drenimin dhe ujitjen e tokes do te pastrohej dhe rregullohej ne menyre te dukshme. Ne parim, kanalet tretesore duhet te trajtohen nga fermeret. Por kjo do te ndodhe vetem atehere kur fermat do te organizohen ne zona me te gjera, dhe kur ekonomia agrikulturore te kete filluar te rilinde. Pra, buxheti mbulon te gjitha koston.

Kablo elektrike te veçanta mund te nevojiten per hidrovoret kryesore, sidomos ai ne Tale. Ujitja e tokes permes ujitesve te levizshem (qe do te furnizohen nga kanalet) nuk permendet ketu. Ky shikohet si mjet kapital qellimi i te cilit eshte zhvillimi i ekonomise agrikulturore dhe mbulohet ne nje kapitull tjetër.

9.3.5 Projekti E-5 Menaxhimi i Zonave Ekologjike dhe Projekte per Infrastrukturen Lokale ose Investime Ambientaliste

Ky projekt do te siguronte infrastrukture te lokalizuar dhe investime ambientaliste qe kane te bejne me te brenda kater tipeve te zonave te mbrojtura, si heqja e ndertesave te jashteligjshme; vendosja e kushteve higjienike ne nyjet e vendosura afer lagunave bregdetare ose ruajtja e bregdetit. Gjithashtu, do te ofronte ndihma financiare apo te tjera qe lejojne vendosjen e organizatave efektive ne menaxhim te veprimeve mbrojtese, duke perfshire edhe pagesen e stafit. Duhet te jete e mundshme vendosja e te ardhurave afatshkurtra dhe afatgjata, permes shfrytezimit te pronave nepermjet shitjes apo qiradhenies, gje qe do te kompensonte daljet buxhetore. Zonat per te cilat behet fjale tregohen ne Figuren 9.1.

9.3.6 Projekti E-6 Programi per Pyltarine Ambientaliste

Ky projekt do te krijonte dhe implementonte nje program pyllezimi, menaxhimi pyjesh (duke perfshire kontrollin mbi prerjen ilegale te lendes drusore) dhe masave kunder gerryerjes qe lidhen me to, duke perfshire pyltarine komerciale dhe projekte ambientaliste. Ne perfytyrojme nje element subvencioni te terthorte nga pyltaria fitimprures dhe keshtu buxheti ne dy fazat me te hershme do te reduktohej drejt zeros, duke lejuar vendosjen e nje sistemi te tille.

9.3.7 Projekti i Reklamimit te Toke se Demshme/Ndotur

Ky projekt do te ndermarre shkaterrim ndertesash dhe heqjen apo mbulimin e dheut te ndotur ne pese zona: shih paragrafin 9.2.6). Kostoja e buxhetit mbulohet nga te ardhurat qe merren nga perdorimi i tokes se rikthyer.

9.3.8 Projekti E-8 Studime mbi Projektet Ambientaliste

Shume prej projekteve te siperpermendura do te kerkojne studime te konsiderueshme ne planin inxhenerik per t'i konfirmuar ato dhe per te krijuar dokumentacionin kontraktual te nevojshem.

9.3.9 Inisiativa te Tjera Ambientaliste

Ka kater inisiativa te tjera, te cilat identifikohen ne kapitujt e tjere, por jane te permbledhura ketu per hir te plotesise.

- Projekte per Ujin e Pijshem dhe Higjienen Paresore dhe Dytesore: shih Kapitullin 7 mbi Infrastrukturen Strategjike
- Menaxhimi i Rritjes Urbane, perfshi planet lokale, fuqizimin dhe kontrollin e zhvillimit, sigurimi i sistemeve tresetore te ujit dhe kanalizimeve te ujerave te zeza etj: shih Kapitullin 6 mbi Zhvillimin Urban.
- Zhvillimi i Turizmit. Peshkimi dhe Pyltaria Komerciale: shih Kapitullin 8 mbi Zhvillimin Ekonomik.
- Zhvillimi Institucional, perfshi ndergjegjesimin publik: shih Kapitullin 11 mbi Implementimin.

9.4 PERMBLEDHJA E PROJEKTTIT

Po permbledhim projektet ambientaliste ne Tabelen 9.1. Llogaritjet e kosos se buxhetit duhet te shihen si skematike, ne versionin me te mire. Ne kemi ndjekur keshillen e stafit te ELPA mbi projektet perreth lumenjve, kanaleve dhe gjerave qe lidhen me to, por padyshim qe nevojitet nje pune edhe me e detajuar perpara se te merren si te besueshme keto llogaritje. Ne kemi gjithashtu elemente te subvencionit te terthorte qe supozohet se do te kompensoje kostot per projektet e Zonave te Mbrojtura, Tokave te Demshme/Ndotura dhe Pyltari e.

Perllogaritja totale e buxhetit eshte rreth € 56.5 milion, ose nje mesatare me pak se € 4 milion ne vit. Buxheti i faza e pare/prioriteti A eshte € 21 milion.

Kodi	Projekti	Prioriteti	Faza / Kostoja			Totali €milion
			I.	II.	III.	
E-1	Ridrejtimi i Lumit Drin dhe Gjader	A	-	7.00	6.00	13.00
E-2	Thellimi i Lumenjve, Pengimi i tyre	A	10.00	5.00	5.00	20.00
E-3	Mbushja Higjienike e Tokes (Faza e Pare) etj	A	4.00	2.00	-	6.00
E-4	Rehabilitimi i Kanaleve dhe Hidrovoreve	A	3.00	0.50	-	3.50
E-5	Menaxhimi dhe Investimi i Zonave te Mbrojtura	B	3.0	1.50	-	4.50
E-6	Pylltaria Ambjentaliste	B	1.0	0.5	-	1.5
E-7	Programi i Reklamimit te Tokes se Demshme/Ndotur	B	2.0	3.0	0.5	5.5
E-8	Studime te Ndryshme te Projektimit Teknik	A	2.0	-	-	2.00
TOTALI			25.0	19.5	11.0	56.50

Tabela 9.1 Permbledhja e Buxhetit te Projektit per Ambjentin